



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

<b>Datë :</b>	<b>03.11.2017</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/10</b>
<b>Për :</b>	<b>Kryetar i Komunes- Imri Ahmeti</b>
<b>Përmes :</b>	<b>Drejtpërsëdrejti</b>
<b>Nga :</b>	<b>Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi</b>
<b>Lënda :</b>	<b>RAPORTI MUJOR-TETOR</b>

## Pasqyra tabelare e punës për muajin – TETOR

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Mbyllje e përko hëshme	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Pëlqime sanitare	Vendosje e shiritav zyrtar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve	Aktvendime- ndalesa, urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Gjoha mandatore	Inspektim i kafshëve në thertore	Inspektime me polici	Inspektim i tokave bujqësore	Biznese të pajegjistruara dhe pa pranime teknike	Mali i pa përshatshëm për konsum
Biznesit	231	14	9			39			7				8	12	96			2		14	
Ambientit	173	15				2			57						99						
Bujqësisë	181	14				40			24						71				32		
Ndërtimtarisë	29	7							15									7			
Trafikut	277	8				60			23		86	8			20			72			
Sanitar	63	6		1			1	1	32	1			3	15			3				
<b>Gjithsejtë</b>	<b>954</b>	<b>64</b>	<b>9</b>	<b>1</b>		<b>1411</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>158</b>	<b>1</b>	<b>86</b>	<b>16</b>	<b>45</b>	<b>301</b>	<b>3</b>	<b>81</b>	<b>32</b>	<b>14</b>			

Gjatë muajit Tetor kemi hasur në biznese të pa regjistruara në qendrën e regjistrimit të biznesit ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjë regjistrimin e tyre pranë qendresë së regjistrimit të bizneseve ARBK-së, Lipjan. Gjithashtu kemi pasur biznese pa pranime teknik të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjienike ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë pranë Drejtoratit të inspektoratit tek inspektorët e tregut.

Me kërkesën e familjarëve është bërë Eks-humimi i dy personave serb nga varrezat e qytetit të Lipjanit, të cilët janë bartur për tu riarrosur në varrezat e qytetit të Jagodines - R. Serbisë.

inspektorët e Mjedisit-Ambientit kanë dalë në vend ngjarje në Qytet, fshatrat Glogovc, Rubovc i Vogël sipas ankesave të bëra nga banorët në lidhje me zhurmën, ndezje të mbeturinave, dhe pengim për kyçje në kanalizim, në të cilat janë shqyrtuar ankesat dhe janë masat e duhura ligjore. Është dalë në teren po ashtu në lidhje me mbeturinat, se mos po hasen qytetarë të pandërgjegjshëm duke hedhë mbeturina në deponit ilegale apo hapësira publike.

Në muajin Tetor është inspektuar në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Vrellë në bashkëpunim me policin kufitare për auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrojnë veprimtari ilegale. Është bërë inspektimi i kompanive të autobusëve në relacione të ndryshme që operojnë në këtë territor se mos ka ndonjë vonës në rëndë e udhëtimit, si dhe kontrollimi i auto-taksive që janë të parkuar në parkingjet e auto-taksit në disa rrugë të qytetit se po hasim ndonjë duke ushtruar veprimtari pa u pajisur me licenc.

Gjatë këtij muaji janë bërë inspektime mbi tokat Bujqësore në regjionin perëndimor të Komunës ku janë fokusuar ndërrim-destinimet e tokës Bujqësore, është inspektuar edhe regjioni lindor të Komunës sonë mbi ndërrim destinimin e tokave Bujqësore, janë inspektuar Barnatoret Bujqësore mbi dokumentacionin përkatës për importim dhe distribuim të farërave dhe plehrave pasi që jemi në sezonin e mbjelljeve vjeshtore sipas ligjeve përkatëse

Janë menaxhuar furnizimet e shkollave me dru për sezonin dimëror.

Gjatë muajit Tetor janë inspektuar disa objekte të ndërtimi dhe inspektuar lokacionet e vend ndërtimeve në terren, gjendja e ndërtimeve është nënë kontrollin e vazhdueshëm inspektues në zonën urbanistike dhe zonat jo urbane. Objekte pa leje ndërtimi gjatë këtij muaji nuk është identifikuar asnjë objekt. Të gjitha inspektimet e realizuara gjatë këtij muaji në objektet e ndërtimit rezultojnë të pajisura me leje ndërtimore, konform Ligjit të ndërtimit.